



BISHZ - VAIS - UIAS - UIAS

BASHKIMI I INTELEKTUALËVE SHQIPTARË NË ZVICËR
VEREINIGUNG DER ALBANISCHEN INTELLEKTUELLEN IN DER SCHWEIZ
UNION DES INTELLECTUELS ALBANAIS EN SUISSE
UNIONE INTELLETTUALI ALBANESI IN SVIZZERA

Programi i punës

BISHZ - VAIS - UIAS

29.11.1997

Versioni 1.0

Id. i dokumentit::	E:\BISHZ\SEKRETARIAT\Programi i punës-1997-SHQ.doc
Klasifikimi:	Vetëm për shfrytëzim të brendshëm
Data	10.11.1997
Emri i fajllit:	<u>Programi i punës-1997-SHQ.doc</u>
Version:	V1.0
Krijuesi:	<u>Dr. sc. Ahmet Xhigoli</u>
Firma:	Bashkimi i intelektualëve shqiptarë në Zvicër (BISHZ)
Përgatitja e fundit:	29.11.1997
U shpërndalet:	BISHZ

Programi i punës

Programi i punës është instrumenti kryesor i cili i bashkon anëtarët e Shoqatës "Bashkimi i Intelektualëve Shqiptarë në Zvicër" (BISHZ). Këtë program e aprovon Kuvendi i BISHZ dhe prej tij Kryesia nxjerrë planet mujore të punës. Pas aprovimit të tij obligohen të gjitha organet e Shoqatës dhe antarësia e sajë që ta zbatojnë.

Drejtimet kryesore të aktivitetit të BISHZ sipas këtij programi janë :

1. organizimi dhe zhvillimi i veprimtarive kulturore,
2. përpilimi dhe realizimi i projekteve profesionale,
3. mbajtja e tribunave me tema të ndryshme.

1. ORGANIZIMI DHE ZHVILLIMI I VEPRIMTARIVE KULTURORE

BISHZ angazhohet për prezentimin dhe afirmimin e vlerave të mirëfillta kulturore të cilat krijohen në trevat shqiptare dhe në diasporë. Duke tubuar rreth vetës krijuesit e lëmime të ndryshme ajo bën prezentimin e krijimtarisë para bashkëkombasve dhe para opinionit zviceran.

Për këtë qëllim organizon:

- manifestime kulturore siç janë: ekspozitat e artistëve figurativ në diasporë dhe të atyre nga trevat etnike;
- bënë promovimin e librave letrarë, organizon manifestime letrare, zgjedh dhe i prezenton opinionit të huaj vlera letrare nga krijuesit shqiptarë në diasporë dhe nga trevat etnike; Sipas mundësive, në bashkpunim me autorët dhe me shtëpi të ndryshme botuese, të bashkëkombasve po edhe të huaja, përgatit dhe boton vepra nga fusha e letërsisë, etj;
- bën organizimin e shfaqjeve teatrore duke animuar artistët nga fusha e teatrit të cilët gjenden në diasporë dhe krijon mundësi për prezentimin e vlerave nga kjo fushë e krijimtarisë duke sjell trupa teatrore dhe krijues nga trevat etnike;
- organizon koncerte të artistëve të afirmuar në lëminë e muzikës serioze, asaj popullore e argëtuese dhe nga fusha e forklorit;
- bën promovimin e video- filmave dhe të videoprogrameve serioze dhe në nivel artistik të cilat momentalisht janë zhanri më frekuentues në tregun kulturor në diasporën shqiptare.

BISHZ me angazhimin e vet merr rolin e një përqyesi të vlerave serioze kulturore deri te opinionit kombëtar dhe i huaj duke ia mbyllur shtegun kiçit, shundit dhe vlerave subkulturore të cilat në këtë kohë kanë monopol mbi publikun që e përbëjnë bashkëkombasit tanë në diasporë.

2. PËRPILIMI DHE REALIZIMI I PROJEKTEVE PROFESIONALE

BISHZ ka në përbërje të vet një numër të konsiderueshëm të kuadrove profesionale nga lëmi të ndryshme. Veprimtaria e tij është e ndarë në 12 seksione: *SEKSIONI PËR SHËNDETESI, SEKSIONI PËR TEKNIKË, SEKSIONI PËR ÇËSHTJE JURIDIKE, SEKSIONI PËR EKONOMI, SEKSIONI PËR POLITIKË, SEKSIONI PËR ÇËSHTJE SOCIALE, SEKSIONI PËR INFORMIM, SEKSIONI PËR KULTURË, SEKSIONI PËR SPORT, SEKSIONI PËR ARSIM, SEKSIONI PËR PËRKTHIME DHE SEKSIONI PËR VEPRIMTARI BOTUESE.*

PROJEKTET E PARASHIKUARA			
Nr.	EMRI I SEKSIONIT	EMRI I PROJEKTIT / KOMENTI	UDHËHEQËSI I PROJEKTIT
1.	SEKSIONI PËR SHËNDETESI	1. <i>Hulumtimi i sëmundjeve profesionale të pjesëtarëve të diasporës të cilët më gjatë qëndrojnë dhe punojnë në Zvicër</i>	
		2. <i>Analiza e shkaqeve dhe statistika e pjesëmarrjes së shqiptarëve në smundjet e Sidës dhe të narkomanisë</i>	
2.	SEKSIONI PËR TEKNIKË	1. <i>Sistemi informativ i Bashkimit të Intelektualëve Shqiptarë në Zvicër</i>	
		2. <i>Nxjerrja statistikore e numrit, strukturës gjinore, moshës, regjionit, dhe e strukturës profesionale të shqiptarëve në Zvicër</i>	
3.	SEKSIONI PËR ÇËSHTJE JURIDIKE	<i>Ky seksion do të angazhohet për çështje juridike të punëtorëve dhe të rinjëve tonë.</i>	
4.	SEKSIONI PËR EKONOMI	<i>Ky seksion do të angazhohet për grumbullimin e mjeteve materiale për financimin e projekteve të Shoqatës</i>	
5.	SEKSIONI PËR POLITIKË-DIPLOMACI	<i>Ky seksion do të angazhohet për çështje politike.</i>	
6.	SEKSIONI PËR ÇËSHTJE SOCIALE-INTEGRIM	1. <i>Efektet e dënimeve me burg, sjellja gjatë qëndrimit në burg dhe resocializimi i pjesëtarëve të komunitetit nshqiptarë të cilët kanë bërë dhe bëjnë vepra të inkriminuara</i>	
		2. <i>Studime komparative të divorcit në diasporën shqiptare, të atij në trevat e tnikë dhe të kësaj dukurie tek Zvicëranët</i>	
7.	SEKSIONI PËR INFORMIM	<i>Ky seksion do të angazhohet për çështje të informimit dhe për nxjerrjen e revistës së BISHZ-së.</i>	
8.	SEKSIONI PËR KULTURË	1. <i>Projekti i parë do të kyç përpilimin e një monografie, me fotografi e fakte e cila do të botohej në një botim ambicioz që do t'i prezentonte shqiptarët si popull. Këtë projekt BISHZ do t'a realizon në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve në Kosovë.</i>	
		2. <i>Projekti i dytë do të kyç xhirimin e video dhe audiokaseta të cilat i prezentojnë trevat shqiptare, traditën, zakonet, folklorin e ritet tona para të huajve. Këtë projekt, BISHZ do t'a realizon në bashkëpunim me Qendrën për Informim të Republikës së Kosovës, me Televizionin shqiptarë dhe me qelula të Televizionit të Prishtinës.</i>	
		3. <i>Projekti i tretë përfshinë përpilimin e një antologjie të letërsisë shqiptare që nga fillet e saj me të cilën do të njiheshin të huajt. Këtë projekt BISHZ do t'a realizon në bashkëpunim me shoqatat e shkrimtarëve në trevat etnike.</i>	
9.	SEKSIONI PËR SPORT	<i>Ky seksion do të angazhohet për sport.</i>	
10.	SEKSIONI PËR ARSIM	<i>Ky seksion do të angazhohet për arsimimin e punëtorëve dhe të rinjëve tonë në kulturë, në gjuhë dhe në profesion.</i>	
11.	SEKSIONI PËR PËRKTHIME	<i>Ky seksion do të angazhohet për përkthime.</i>	
12.	SEKSIONI PËR VEPRIMTARI BOTUESE	<i>Ky seksion do të angazhohet për veprimtari botuese të Shoqatës</i>	

3. MBAJTJA E TRIBUNAVE ME TEMA TË NDRYSHME

Anëtarët e BISHZ përmes shoqatës të tyre do të angazhohen për të ndikuar në opinionin publik dhe për të krijuar opinionin tek bashkëkombasit e sidomos tek të huajt. Për këtë qëllim do të bëhet një bashkëpunim i mirëfilltë me gazetatat ditore dhe me shtypin periodik i cili botohet në diasporë, po edhe me gazetatat domicile në Zvicër. Ky segment i veprimtarisë së BISHZ do të realizohet me themelimin e një Tribune të BISHZ e cila do të funksionojë në vazhdimësi. Në këtë Tribunë për çdo muaj do të nxjerret për diskutim nga një temë e cila ndërlihet me aspekte të ndryshme kombëtare, shoqërore, politike, psiko-sociale e kulturore.

TEMAT E PARASHIKUARA			
TRIBUNA NR.	TEMA	DATA E MBAJTJES	SEKSIONI PËRGJEGJËS
T-001	Organizimi i një simpoziumi me karakter ndërkombëtar lidhur me Ekzodin e shqiptarëve		
T-002	Animimi dhe sensibilimi i opinionit zviceran dhe europian për problemin e Kosovës dhe të shqiptarëve në Magedoni		
T-003	Shoku kulturor dhe shqiptarët si komunitet në Zvicër		
T-004	Trajtimi i shqiptarëve në shtypin zviceran dhe atë europian dhe krijimi i stereotipeve për ta		
T-005	Kriza e familes shqiptare në diasporë, eurozioni i moralit dhe kriminaliteti si dukuri që përcjell komunitetin shqiptar në mërgim		
T-006	Brezi i dytë i shqiptarëve në Zvicër dhe Europë, mundësitë e ngritjes profesionale të këtij brezi në dhe të huaj		
T-007	Organizimi i shqiptarëve në diasporë		
T-008	Martesat e përziera, për dhe kundër		
Këto tema janë të formuluar si tema bosht dhe mund të strukturohen në nëntema të caktuara.			

Realizimi i këtij programi nënkupton përkrahjen financiare të vetë anëtarësisë, të donatorëve dhe të shtetit zviceran si dhe bashkëpunimin me institucionet në trevat etnike, me ato zvicerane, me mjete të informimit dhe me individë-ekspertë dhe profesionistë të lëmive të ndryshme, pavarësisht se a janë anëtarë të BISHZ.

Bernë, 29 nëntor 1997

Kryetari i BISHZ-së
Dr. sc. Ahmet Xhigoli